ERIC P. HAMP

I. *HA* = IE. + *ED* —
II. *VESHTULL* «VISCUM ALBUM»

I. Megjithëse prej kohësh janë bërë përpjekje për të zgjidhur etimologjinë e kësaj fjale të vështirë por themelore nga ana leksikore, disa aspekte të morfologjisë së saj duken të qarta e të pamohueshme, ndonëse ne ende mund të mos jemi në gjendje të arrijmë një siguri të plotë lidhur me prejardhjen e saj të saktë nga të gjitha pikëpamjet. Nuk ka dyshim, që një gjuhë mund ta ketë zëverdësuar plotësisht morfemën e vjetër në këtë kategori kuptimore, kështu që duhet të jemi të pregatitur për ta patur parasysh një mundësi të tillë edhe për shqipen; brenda indo-europianishtes zëvendësime të tilla kanë ndodhur në indishten, iranishten, greqishten e vonë, në shumicën e gjuhëve romane, në gjuhën e Uellsit dhe në bretonishten. Por nëse do të gjenim një shpjegim, i cili mbështetet në pranimin e vazhdimësisë së morfemës origjinare, atëhere ky shpjegim gjithnjë do të parapëlqehej.

Është e qartë që brenda shqipes ne duhet të nisemi nga forma toske: *hā ha, hëngër-, ngrënë*. Gegërishtja veriore (duke përfshirë Arbanasin) na dëshmon gjatësinë / shkurtësinë e këtyre temave të së tashmes. Arvanitikaja na siguron për vokalizmin dhe rrokjezimin e preteritit.

Trajta e pashtjellë është pa dyshim më e qarta. Rrënja duhet të jetë ajo që shihet në Βρωτός «i ngrënshëm» dhe lit. *gîrtas* dhe formimi shkon shumë afër me të skt. *gīrṇá-* «i gëlltitur». Këtu kemi të bëjmë me po atë problem krejt njësoj si për togun e vjetër të bashkëtingëlloreve që e kanë mbrojtur hundoren nga rotacizmi në toskërishten, tog të cilën e shohim gjithashtu në rrënjë të tilla vokalike si *dhënë* dhe *thënë*. Për më tepër duhet të pranojmë preverbin, që është i zakonshëm në shqipen. Kështu kemi një mbiemër të vjetër foljor $+ en - g^{w} r\ VC - no -$.

Meqë bazat e *ngrënë, dhënë* ($+ doH_{o}$-) dhe *thënë* ($+ \acute{k}eH$-) janë të gjitha me një laringale fundore, kjo na shtyn të mendojmë se mos në protoshqipen laringalja në këtë pozicion është ruajtur shumë vonë dhe është bashkuar si një tingull jo-rrokjesor me hundoren pasuese, kështu që ka jetuar si një bashkëtingëllore në një tog.

Është e natyrshme gjithashtu që po atë bazë dhe preverb në preterit t'i njohim si një aorist i lashtë; këtu mund të bëjmë krahasim me ἔβρων dhe në veçanti në armenishten *eker* $< + e - g^{w} erH - e - t$. Është e vështirë të themi nëse shqipja shkon pas tek $+ - g^{w} erH -$ apo tek

+ -*g* ^{w} *rH* - në bazë të dëshmive dhe të njohjes sonë të pakët që kemi për fatin e segmenteve të tilla.

Pasi i kemi njohur këto pjesë të preteritit, shohim se shpjegimi i vetëm i arësyeshëm për *hë* - është ta quajmë një preverb të vjetër. Si pasojë e kësaj, do të shohim se më e mira është ta marrim *h* - nistore të së tashmes si reflektim të po atij preverbi. Më poshtë do të kthehemi edhe një herë për të parë trajtën më të përpiktë të këtij preverbi.

Shohim tashti që kjo folje supletive bazën + *g* ^{w} *erH* - e ka rrëgjuar në aoristin e vjetër dhe në trajtën e pashtjellë. Pikërisht po kjo gjë është pranuar origjinarisht që gjendet në bazën e paradigmave të greqishtes, sanskritishtes, balto-sllavishtes dhe armenishtes; për shembull, Frisk GEW 1,236 i vë aoristin dhe perfektin në bazë. Këtu pra e shohim shqipen që ruan një tipar mjaft të lashtë, siç bën edhe në disa folje të tjera supletive. Të tashmet si skt. *giráti* dhe sllavishtja žbro duhet të shihen si formime më të reja. Latinisht *uorāre* është me siguri një derivim i dytë.

Nëse shqipja na ka ruajtur një supletivizëm kaq të lashtë, ne kemi arësye të kërkojmë një shpjegim, i cili do të plotësojë pjesën që mbetet të këtij konfiguracioni kaq konservativ. Ne dimë që rrënja **ed* — ka qenë në indoevropianishten e vonë në fillim një e tashme atematike; më tej, mbi baza fonologjike një **d* e brendshme ose do të jetë zhdukur midis zanoreve, ose është thithur në mjaft kombinime me bashkëtingëllore. Po ta lidhim këtë me preverbin në *h* - që njohëm më sipër, na mbetet vetëm të përcaktojmë vokalizmin origjinar. Në bazë të asaj që kam paraqitur në *Evidence for Laryngeals* një *h* - e tillë ka të ngjarë të jetë origjinarisht një laringale me ngjyrim *a*- në *ie.*; e megjithatë, nëse forma ka qenë një shkallë *o* origjinare në apofoni, rezultati do të ishte i njëjtë për vokalizmin e shqipes. Dëshmia e armenishtes këtu na del njëkohësisht si ndriçuese dhe si e sqaruar; vokalizmi i arm. *utem* ka qenë gjithmonë një gjëzë e pazgjidhur, e megjithatë supletivizmi i asaj që është supozuar si **ed*- dhe **g*^{w}*erH*- në këtë gjuhë duhet të quhet një tipar arkaik, siç e përmendëm më lart për shqipen. Armenishtja *u*- duhet të jetë **ō* -; po ta barazojnë këtë me shqipen *ha* shohim se duhet të kemi të bëjmë këtu me një vokalizëm të lashtë **o*. Atëhere unë mendoj që për armenishten kjo **o - ed - e - m* - ka pësuar një shkrirje zanoresh të tillë **oe* > **ō* Nga ana tjetër, në shqipen ne mendojmë **háedm-*>*háëm-*>+*hām-* etj.; mundësia tjetër, në rast se nisemi nga shkalla origjinare zero e shumësit, mund të kemi pasur **hô-' dm* - > **hádm-*>**hā m-* etj.

Sido qoftë, ne paraqesim si hipotezë për armenishten dhe shqipen, në këtë të dytën si për të tashmen dhe për aoristin, një preverb të theksuar **ho-*. Ka të ngjarë që kjo ka qenë një pjesëz perfektive, e ngjashme me ato që dalin në lat. *com- edere*, gjerm. *fr-essen*.

Zhvillimi i mëtejshëm brenda shqipes është i drejtpërdrejtë: **hó - edmi hó-eds hó-edt* > **háëmi haëss háëc (t)* >**hāmi hāss* hāć (të), pikërisht si me preteritet e temave të lashta me zanore, para bashkëtingëllores fundore të njërrokëshave të tillë zanorja është shkurtuar; kështu kemi *hā (m) ha ha.*

Rindërtimi më i hershëm që mund të arrihet për këtë folje arkaike duket se do të jetë, mbi bazën e morfologjisë së brendshme, **hó- edmi hó-en-gw Vr en-gwr VC-no;* ndoshta kjo ka qenë **hō-ed-mi *hó-en-g*^{w} *rH*- *-V-en-g*^{w}*rH-no.* Vokalizmi i aoristit nuk mund të shkojë prapa

drejtpërdrejt te +*e*, përndryshe ne do të prisnim **hânzër* - ose + *hânxër*. Duke gjykuar sipas armenishtes, preverbi **ho* origjinarisht mund të jetë rrëgjuar në trajtën e kohës së tashme; atëhere do të jetë përgjithësuar për gjithë foljen e shtjellë në shqipen. Po të jetë kështu, ndoshta me këtë folje kemi patur origjinarisht preverba perfektivë supletivë, diçka sipas modelit që gjejmë në irlandishten e vjetër, me **ho* për të tashmen dhe **en* për jo-të-tashmet (të paktën për aoristin e vjetër).

Në rast se arësyetimi i mësipërm do të pranohet, atëhere ne kemi rindërtuar një rrënjë tjetër *ie*. për shqipen; për më tepër, kjo folje me sa duket është një nga më arkaiket në format e dëshmuara.

* * *

II. Disa kohë më parë (American Journal of Philology, 1954) unë kam propozuar që *sjetull (ë)* të shihet si e prejardhur nga tema indoevropiane **kʷe-kʷl-o-* «(fjalë për fjalë), tajar», që shihet në skt. *cakrá -*, angl. e vj. *hʷēol* «rrotë». lit *kãklas* «qafë». Për mua është kuptimplotë që baltishtja dhe shqipja përputhen në këtë, duke ja veshur këtë term një pjese të trupit të njeriut. Zhvendosja e vokalizmit baltik në *a* është e vështirë të shpjegohet, por mund të ketë të bëjë me këtë një konfiguracion me një likuide në rrokjen pasuese, që na jep përshtypjen e një prapashtese me apofoni të re në gramatikën e baltishtes; shih artikullin tim të fundit në Baltistica, 1970.

Kjo hipotezë kërkonte që të pranoj ndërrimi **Kʷl* ->**-kl*-> *-*təl* ->+-*təł* ->* -*təł* ->*-*tuł* -. Tashti po shoh që kemi një rast, i cili na e pohon këtë zhvillim pa qenë nevoja të nisemi nga një formë hipotetike e rindërtuar.

Veshtull -i duhet të nxirret nga tema latine e huazuar *viscum*. Kjo përmban prapashtesën *l-* që gjendet në emrat e bimëve, inter alia; shih M. Camaj, Albanische Wortbildung, wiesbaden, 1966, 118, § 86 c. Ne duhet të supozojmë për këtë fjalë të prejardhur një zhvillim **visk(u)lu-*>**vẹstla-*>**Vẹstəla-*>**vestula*>*veštul-*.

Pra unë mendoj që forma tjetër e dëshmuar *veshkull* është formuar sërishmi më vonë nga fjala e thjeshtë *veshk*.

Atëhere me sa duket mund të caktojmë për periudhën pasromane një ndërrim **-kl*>*-tuł-* = *tull*.